

UDHËZIM
Nr.7, datë 7.5.2007

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË SHPRONËSIMEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 8 të ligjit nr.9601, datë 28.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”” për përdorimin e fondit të shpronësimeve

UDHËZOJ:

1. Ministritë dhe institucionet qendrore të paraqesin në Ministrinë e Financave - Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit kërkesën për shpronësim, e cila duhet të ketë bashkëngjitur vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësimin e kërkuar.

2. Ministria e Financave e miraton kërkesën në rast se shpronësimi bëhet për projekte të programeve prioritare të Qeverisë dhe nëse fondet, në llogarinë “Fondi i shpronësimeve” pranë Bankës së Shqipërisë, janë të mjaftueshme.

3. Pagesa e të shpronësuarve të bëhet si vijon:

- Ministritë dhe institucionet qendrore përkatëse, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave, për çdo individ apo subjekt të shpronësuar krijon dosjen përkatëse, në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”.

- Me përfundimin e kompletimit ligjor të dosjes, ministritë dhe institucionet qendrore përkatëse hartojnë listëpagesën për dosjet e përfunduara (sipas formatit bashkëngjitur këtij udhëzimi).

- Listëpagesa e miratuar zyrtarisht nga titullari i ministrisë ose institucionit qendror i bashkëngjitet kërkesës zyrtare dhe paraqitet për pagesë pranë Ministrit të Financave.

4. Ministri i Financave, bazuar në listëpagesën bashkëngjitur kërkesës, lëshon urdhërpagesën për Bankën e Shqipërisë, e cila kryen transfertat në llogaritë personale bankare të të shpronësuarve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

[illegible]

Personat e autorizuar per plotesim dosje dhe likuidim

Emri Mbiemri	Detyra funksionale	Firma
--------------	--------------------	-------

2

1

2

3

4

5

MIRATOHET

TitullariVula